



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 86-Gusht- 2010 ZYRA PËR INFORMIM - [http://kk.rks-gov.net/malisheve/
www.malisheva-komuna.org](http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org)



Përmbajtja



U mbajt koncerti per bashkatdhetarët	2
Varrosen inspektori komunal Hamit Gashi dhe dy anëtarë të kësaj familje .	4
Sot fillon intervistimi i i kandidatëve për mësimdhënës	4
Gjatë periudhës së thatësisë të furnizohen me ujë të pijës,rastet e rënda	5
Shënohet dymbëdhjetë vjetori i rënies së Komandant Kumanovës	6
Të gjitha shkollat të gatshme për fillimin e procesit mësimorë.....	7

U mbajt koncerti për bashkatdhetarët

Malishevë, 10 gusht

Mbrëmë në ambientet e pishinave në Banjë, u mbajt një koncert dedikuar bashkatdhetarëve nga komuna e Malishevës, në shenjë respekti për kontributin e tyre dhe për t'ju dëshiruar mirëseardhje në vendlindjet e tyre.

Në vazhdim, pjesë nga fjalimi i nënkryetarit të komunës së Malishevës, z.Rexhep Mazreku, drejtuar bashkatdhetarëve:



“Të Nderuar dhe të respektuar bashkatdhetar, mirë se keni ardhur në programin muzikor dedikuar juve.

Viti 2010 është viti i tretë pas shpalljes së Kosovës shtet të pavarur sovran dhe demokratik. Ky shtet u bë fal luftës së UÇK-së, fal punës këmbëngulëse të shumë atdhetarëve, falë gjakut të derdhur në shumë etapa të historisë sonë kombëtare, duke përfutur ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare dhe NATO-s për çka i falënderojmë dhe i u jemi mirënjohës për jetë. Në këtë aspekt kontribut të veçantë ka dhënë diaspora jonë e nderuar dhe shumë e respektuar, si në sensibilizimin e opinionit në shtetet ku kanë punuar dhe vepruar, pastaj ndihma në mjete materiale, duke përkrahur fuqishëm familjet e veta, por edhe çdo aksion me rëndësi shoqërore dhe kombëtare. Nuk harrohet ndihma rreth mbajtjes gjallë të shkollës së pavarur shqipe, pas viteve 90 –ta, pastaj sakrifica, gjegjësisht lërja e punës dhe familjes dhe kyçja e një pjese të bashkatdhetarëve në luftën e UÇK-së dhe shumë aktivitete në shërbim të atdheut. Prandaj më lejoni që në emër të Komunës së Malishevës, kryetarit Kilaj dhe kolegëve dhe qytetarëve tanë, t’ju falënderoj dhe ne ju jemi mirënjohës për gjithë kontributin që keni dhënë gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë suaj.

Më tej zëvendëskryetari ka vazhduar duke përmendur disa nga të arriturat në komunën e Malishevës. Sipas z. Mazreku: “Malisheva 11 vjet pas çlirimit ka marr një pamje krejt tjetër nga ajo që e ka pasur. Të gjitha fshatrat janë shtruar me shirit asfalti, në disa janë bërë ujësjellës dhe kanalizime, janë ndërtuar shumë shkolla dhe po ndërtohen edhe të tjera. Vlen të përmenden ndërtimet e viteve të fundit si Shkolla e Mesme Profesionale që quhet Qendra e Kompetencës, investim shumë kapital, Palestra Sportive “Habib Zogaj “ , Shtëpia e Kulturës ” Tahir Sinani” , ShFMU “Naim Frashëri” në Banjë, 3 fusha sportive nëpër shkolla dhe shumë investime tjera, po ia japin Malishevës pamjen e një qyteti modern, ku qytetarët tanë japin kontributin e tyre të përditshëm. Këto investime dhe tjerat që po bëhen do t’ia përmirësojnë dukshëm jetën e familjeve dhe qytetarëve tanë.



Në fund zëvendëskryetari i komunës, Rexhep Mazreku, ka falënderuar edhe një herë bashkatdhetarët, duke uruar që të kalojnë mirë në vendlindjet e tyre.

Varrosen inspektori komunal Hamit Gashi dhe dy anëtarë të kësaj familje

Balincë, 11 gusht

Sot rreth orës 18:00, në varrezat e fshatit Balincë, janë varrosur tre anëtarët e familjes Gashi, të cilët humbën jetën tragjikisht në një aksident trafiku, në afërsi të Kijevës. Në këtë aksident kishin humbur jetën Hamit Gashi (1972), inspektor komunal për komunikacion dhe veteran i luftës i UÇK-së, dhe dy nipërit e tij, Arbnor Gashi (1988) dhe Bleart Gashi 2002.

Me këtë rast, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, familjes Gashi i ka dërguar një telegram ngushëllimi, duke i shprehur ngushëllimet më të sinqerta në emër të tij dhe të të gjithë qytetarëve të komunës së Malishevës, duke u shprehur se ndajnë dhimbjen me familjen Gashi.

Me të kuptuar për rastin, kryetari ka ndërprerë pushimin vjetor, i cili ndodhej me familjen e tij jashtë Kosovës, për t'iu bashkuar dhimbjes së familjes Gashi dhe për të marrë pjesë në ceremoninë e varrimit, me ç'rast edhe ka vendosur kurora me lule mbi varret e viktimave të këtij aksidenti.

Në emër të Komunës së Malishevës, një fjalim rasti e ka mbajtur zëvendëskryetari Rexhep Mazreku. Në vazhdim, fjalimi i nënkryetarit.

Sot fillon intervistimi i i kandidatëve për mësimdhënës

Malishevë, 16 gusht

Në kuadër të përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor, përveç riparimeve nëpër shkolla, aty ku ka pasur nevojë dhe dy objekteve të reja shkollore në Mleqan e Senik, nga dita e sotme fillon edhe mbajtja e intervistës për kandidatët që kanë aplikuar për mësimdhënës.

Këto njoftime i bëri drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Isuf Morina, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, të cilin sot e udhëhoqi zëvendëskryetari i komunës, z.Rexhep Mazreku.



Drejtori Morina, bëri të ditur se për 160 vende për mësimdhënës, kanë aplikuar 710 kandidat, gjithashtu në lidhje me puniket në Qendrën e Kompetencës, shtoj se objekt do të jetë plotësisht gati për muajin tetor, kur edhe duhet të filloj procesi mësimor, sipas planifikimit.

Në këtë mbledhje, zëvendëskryetari Mazreku, kërkoi nga drejtoritë përkatëse, që të vazhdohet me efikasitetin në punë, në kryerjen e shërbimeve në raport me qytetarët, në veçanti gjatë këtyre muajve, kur qytetarët tanë që jetojnë në botën e jashtme, kanë nevojë për shërbime më të shpejta.

Gjatë periudhës së thatësisë të furnizohen rastet e rënda me ujë

Malishevë, 23 gusht

“Të gjitha kategoritë e rënda sociale, që nuk kanë mundësi të furnizohen me ujë për pije, gjatë kësaj periudhe, duhet të vazhdohet furnizimi i tyre me ujë, pa pagesë, nga ana e shërbimeve kompetente”, ka kërkuar kryetari i komunës z.Isni Kilaj, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve.

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, ishte i ftuar të raportoj për gjendjen e furnizimit me ujë për pije edhe përgjegjësi i njësisë së Hidroregjionit jugor në Malishevë, Njazi Bytyçi. Bytyçi, bëri të ditur se ka mungesë të furnizimit me ujë në fshatin Carrallukë, për shkak të reduktimeve të rrymës, përderisa në ujësjellësin për fshatrat Bubël-Damanek-Qypevë, ka furnizim me reduktime, kurse në Gurbardh, ende nuk ka furnizim me ujë për shkak të disa problemeve në atë sistem.

Janë diskutuar edhe çështje tjera të punës në përgjithësi, ndërsa është shprehur shqetësimi i prishjes së rendit dhe qetësisë publike, si nga lokalet afariste, ashtu edhe nga qytetarët, në veçanti me zhurmën që po krijohet për shkak të ahengeve familjare, ku ka pasur ankesa të shumta të qytetarëve.

Në këtë takim është njoftuar edhe për përgatitjet intensive që janë duke u bërë, nga ana e Drejtorisë së Arsimit, për fillimin e vitit të ri shkollor.

Shënohet dymbëdhjetë vjetori i rënies së Komandant Kumanovës

Kleçkë, 25 gusht



Në këtë tubim, përveç mijëra qytetarëve, morën pjesë edhe ministri i MTPT-së, z.Fatmir Limaj, kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, kryetari i SHVL të UÇK-së, Muharem Xhemajli, pastaj ish udhëheqësi i lartë ushtarak i UÇK-së, Rexhep Selimi, kryetari i komunës së Likovës në Maqedoni, z.Sadullah Duraku, etj...

Duke marrë fjalën, Muharrem Xhemajli, në emër të SHVL të UÇK-së, Malet e Berishës i quajti “Kala e pamposhtur”, përderisa, sipas tij në këto male u morën vendime të rëndësishme për të ardhmen e Kosovës dhe vendi prej nga koordinoheshin veprimet diplomatike të UÇK-së.

“Jemi në vendin ku asnjëherë nuk kishte shkelur këmba e armikut dhe për këtë jemi krenar, por këtu jemi edhe në majat e lavdisë së UÇK-së”, tha mes tjerash, Rexhep Selimi, duke nderuar veprën e dëshmorëve të Brigadës 121 dhe të gjithë dëshmorëve të kombit.

Ndërsa, ministri i MTPT-së, z.Fatmir Limaj, duke folur për rëndësinë e 25 gushtit, tha se kjo datë na përkujton momentet më të lavdishme, por edhe më të rëndat që përjetoi treva e Llapushës dhe Malet e Berishës. Djemt dhe vajzat tona, sakrifikuan jetën e tyre, për të ardhmen Kosovës”, tha ministri Limaj, i cili bëri thirrje që më shumë të bëjmë për njëri tjetrin. “Nuk ka askush që na ndal në realizimin e idealeve që kanë pasur dëshmorët”, tha ministri i MTPT-së, njëherit ish komandant i Brigadës 121, Fatmir Limaj.

Tubimin e ka përshëndetur edhe kryetari i komunës së Likovës, z. Sadullah Duraku, duke sjellë edhe përshëndetjet e kryetarit të BDI-së, z.Ahmeti. “Sot jemi të gjithë shqiptarët bashkë dhe na mbetet që amanetin e dëshmorëve të të gjitha trevave shqiptare ta qojmë në vend”, tha kryetari Duraku.

Besim Çelaj, në emër të familjarëve të dëshmorëve, ka falënderuar të pranishmit, ndërsa më pas janë bërë nderime dhe janë vendosur kurora me lule, pran varreve ku prehen 65 dëshmorët e Brigadës 121 “Ismet Jashari-Kumanova”.

Të gjitha shkollat të gatshme për fillimin e procesit mësimorë

Malishevë, 30 qusht



Në një mbledhje të mbajtur sot, nga Drejtoria komunale e Arsimit, me të gjithë drejtorët e shkollave fillore dhe mesme të komunës së Malishevës, është konstatuar se të gjitha objektet shkollore janë të gatshme për të filluar procesi mësimor, 2010-2011.

Drejtori i Drejtorisë komunale të Arsimit, Isuf Morina, ka kërkuar nga drejtorët që të bëjnë një fillim madhështor të vitit mësimor. Morina ka njoftuar gjithashtu se tekstet shkollore janë falas edhe për këtë vit, nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në këtë mbledhje ka marrë pjesë edhe Udhëheqësi i Inspektorëve Rajonal (USI) të Arsimit, Zef Osmani, i cili nga kompetencat e veta, ka njoftuar të pranishmit për procesin e inspektimit që bëhet në vazhdimësi.

Sipas z. Osmani “qëllimi i inspektimit të shkollave, nuk do të thotë se ka orientime vetëm në zënien e gjërave jo të mira, mirëpo inspektimin duhet kuptuar si bashkëpunim midis komunave dhe Ministrisë së Arsimit”.

Para pjesëmarrësve në takim, z. Osmani, ka prezantuar planin e punës për vitin 2010, sipas të cilit, për pjesën e parë të vitit është planifikuar të inspektohen shkollat, në lidhje me përgatitjet teknike, regjistrimin e nxënësve në klasat e para të shkollave fillore dhe në klasat e dhjeta të shkollave të larta, pastaj pjesa ka të bëjë me inspektimin e programin e punës, në të cilin përfshihet: plani i punës për vitin shkollor 2010-2011, plani i punës së drejtorit të shkollës, plani i punës së Këshillit të shkollës, planet e punës së Këshilltarëve të klasave dhe Aktiveve profesionale dhe planet e punës së Këshillit të Prindërve, Këshillit të nxënësve dhe të aktiviteteve të lira, ndërsa pjesa e tretë e inspektimit ka të bëjë me format e përzgjedhjes së lëndës për mësim zgjedhor, planprogrami për mësim



zgjedhor, kualifikimi i mësime dhënësit të angazhuar për mësime zgjedhor, si dhe do të bëhet inspektimi i orëve mësimore sipas Planit të punës që do të hartoj sektori.